

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SMILE PIZZA SHPK**

Sot, më 21.02.2022, në Tiranë, me cilësinë e Ortakut themelues të shoqërisë:

Elvis Cara, lindur më 15.05.1990 në Kavajë, Shqipëri, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. 034174442, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ka vendosur themelimin e shoqërisë Smile Pizza Shpk.

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi të një shoqërie tregtare, nënshkruesi e themeluesi i saj, merr përsipër të realizojë e të respektojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga klauzolat e mëposhtme, të cilat do të specifikohen gjerësisht në Statutin e Shoqërisë:

THEMELIMI I SHOQËRISË

Në mbështetje dhe zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe ligjin nr. 9723 dt 0305.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” themelohet Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “Smile Pizza” Shpk (më poshtë në këtë akt e quajtur “Shoqëria”) nga Ortaku themelues i saj.

FORMA E SHOQËRISË

Shoqëria “Smile Pizza” Shpk, më poshtë referuar si Shoqëria, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar krijuar në bazë të ligjit NR. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe rregullohet prej këtij ligji dhe statutit të shoqërisë si dhe prej çdo dispozite tjetër ligjore të aplikueshme.

II EMRI I SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

**Neni 1
Emri**

Emri i shoqërisë është “Smile Pizza” Shpk. Në çdo dokument, faturë, reklamë dhe publikime emri i shoqërisë do të pasohet nga:

- a. Fjala “me përgjegjësi të kufizuar” apo shpk
- b. Numri i saj i regjistrimit
- c. Selia

**Neni 2
Selia**

Selia administrative e shoqërisë do të jetë: Rruga e Fshatrave Turistikë, Godina 5-katëshe, Kati I, Zona Kadastrale Nr. 3101, Nr. i pasurisë: 16/42-N1, 16/42-N2, Qerret, Kavajë, Shqipëri

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Veprimtaria e Shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe do të zgjasë për një afat kohe të pacaktuar.

III OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4 Objekti

Objekti i Shoqërisë do të jetë: Restorant, piceri dhe fast food.

IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) lekë, i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm. Ortakët e Shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tyre në Shoqëri janë si më poshtë:
Elvis Cara, lindur më 15.05.1990 në Kavajë, Shqipëri, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. 034174442 që zotëron një kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, në vlerën 100 (njëqind) lekë.

Neni 6 Organizimi

Shoqëria do të drejtohet nga një administrator. Këtë detyrë do ta kryejë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, Z. Elvis Cara, i cili do të ushtrojë të gjitha kompetencat për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë, për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti ja jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.

Ortaku i vetëm i Shoqërisë

Elvis Cara

FLAVI CARA

